



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI
VENDIM**

Nr. 157, Datë 28.09.2017

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË
LLOGARITJES SË TARIFAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20 gërma a; nenit 108 pika 3 dhe nenit 110 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në zbatim të nenit: 21, 22 dhe 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Proçedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin nr. 96 datë. 17 .06. 2016; VKM nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 28.09.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurave për miratimin e “draft–Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike” të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve,

Konstatoi se ,

- Në përmbushje të këtij detyrimi drejtoritë teknike në bashkëpunim me konsulencen e USAID kanë përgatitur draft metodologjinë e llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.
- Drafti i metodologjisë së llogaritjes së tarifave të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, mbështetet në parimin “price cap” i njëjtë me metodologjinë egzistuese të llogaritjes së tarifës të transmetimit të energjisë elektrike e miratuar me Vendimin nr. 59, datë 29.12.2005, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, por e modifikuar dhe përshtatur në mënyrë që të reflektojë ndryshimet sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.
- Ndryshimet e propozuara mbështeten në praktikën dhe eksperiencat e deritanishme të miratimit dhe rishikimit të tarifave. Këto ndryshime, nuk ndryshojnë thelbin e metodologjisë ekzistuese, por ky draft që po paraqesim përmban ndryshime teknike në lidhje me kërkesat për komponentet përbërës të tarifës nisur nga praktika dhe eksperiencia e deritanishme.
- Për përcaktimin e vlerës së RAB është propozuar të përdoret parimi i kostos historike në vend të parimit të kostos së zëvendësimit që aplikohet në metodologjinë ekzistuese.
- Formula e llogaritjes së WACC propozohet të njësohet me metodologjinë e llogaritjes së tarifave të shërbimit të shpërndarjes e cila përfshin e tatimin e fitimit, në përputhje

me praktikat më të mira të financave të korporatave. Norma e lejuar e kthimit mbi Asetin Bazë të Rregulluar do të jetë mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit para taksave.

- Problematika e rrezikut të kursit të këmbimit valuator për normën e interesit gjen zgjidhje me shtesën e propozuar në dispozitën 4.9 i cili mundëson një premium mbi normën e borxhit si pjesë të normës së interesit me qëllim mbulimin e riskut të shkëmbimit të monedhës.
- Për përcaktimin e normës së lejueshme të kthimit të kapitalit të vetë, në nenin 4 pika 7 është propozuar që në llogaritjen e tij të merret parasysh edhe nevoja e OST për shërbimin e borxhit.
- Në nenin 7 pika 2 është propozuar që, elementeve që figurojnë në metodologjinë aktuale dhe merren në konsideratë për të bërë rregullime/axhustime në të ardhurat e vitit të testimit, t'u shtohet edhe elementi “të ardhura te tjera”.
- Për hartimin e planeve të investimeve sa më reale e të realizueshme, nëpërmjet dispozites 4.5.2 propozohet që të rishikohen/ të korigjohen tarifat në rast se OST dështon në zbatimin e planit të investimeve.
- Dispozita 7. 5 përcakton se çmimi mesatar i energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në transmetim gjatë vitit bazë do të vendoset në tregun e parregulluar.
- Është kryer përditesimi i termave të përdorur në metodologji konform përcaktimeve të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

- 1 Fillimin e procedurave për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike.
- 2 Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari
Petrit AHMETI